



Npi – 01/292 datë: 30.08.2024

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 04.07.2024, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -VIII-të, të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes, mbajtur më datë 30.08.2024 (e premte), në ora 09:00h, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhjen e Kuvendit, kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emimi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, znj.Albana Podvorica, z.Lumni Amrushu, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, të gjithë Drejtorët e drejtorive komunale, Shefja e Kabinetit, znj.Anita Kurti, nga Zyra për Informim, znj.Vlora Hyseni, Zyrtarët e IT-së, z.Miftar Miftari, Asistentja e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti,

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe pasi konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, njoftoi Kuvendin me pikat e propozuara për këtë seancë, si vijon:

R E N D I I D I T Ë S

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 04.07.2024;
2. Raporti i auditimit të ZKA-së për pasqyrat financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2023;
3. Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023;
4. Raporti buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024;
5. Draft-Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (për diskutim publik);
6. Propozim-Vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/189 dt.06.09.2012, për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqes prej 50 ari truall, Policisë së Kosovës njësi në Shtime;
7. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për emërtimin e Objekteve Publike;
8. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për emërimin e Rrugëve dhe Shesheve;
9. Informatë nga DKA për përfundimin e vitit mësimor 2023-2024 në Komunën e Shtimes;
- 10. Propozim-Vendim për miratimin e drejtorive komunale, (Pikë shtesë);**
11. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fillimisht ju ftoj për një minut heshtje për nderë të profesorit Ismajl Hasani nga Shtimja, i cili ka ndërruar jetë. (Nderime). Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Përshëndetje për të gjithë. Fillimisht ju njoftoj se ne kemi pranuar një shkresë nga MAPL-ja e cila ka të bëjë me një ankesë të bërë nga opozita, në lidhje me shtimin e numrit të drejtorive komunale. Ne, në formimin e drejtorive komunale, jemi bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në nenin 56.2 të Statutit të Komunës së Shtimes. MAPL-ja na ka dërguar një rekomandim që vendimi për formimin e drejtorive komunale, në bazë të statutit të komunës, duhet të miratohet edhe njëherë në Kuvend. Prandaj, ne jemi të obliguar që vendimin për formimin e drejtorive ta qesim për miratim në Kuvend. Për këtë arsye unë propozoj që Kuvendi ta fusë si pikë shtesë të rendit të ditës edhe këtë pikë “Formimin e drejtorive komunale”, për miratim formal.

z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje! Sot po propozohet me e futë këtë pike shtesë e kur ne diskutojshim për këtë jemi përqeshur. Po vërtetohet se atë që e kemi thenë ne është e vërtetë. Ne jemi kundër këtij vendimi, për sistematizimin, është çështje e Kryetarit dhe kërkojmë të anulohet. Neni 58 i LVL-së e përcakton mirë se çka mundet me vendosë Kryetari, Me këtë rast kemi një shkelje ligjore. Unë jam kundër sepse po na vien dy minuta para mbledhjes.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetj, në emër të PDK-së, i shprehë ngushllime familjes Hasani për vdekjen e profesorit Ismajl Hasani. Pajtohem me rendin e ditës, por jo edhe me pikën shtesë që u propozua nga Kryetari. Qe tetë muaj i ka paguar dy drejtor kundërligjshëm, le ta dinë qytetarët. Ne jemi kundër pikës shtesë.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje! Ne si grup parlamentar i LVV-së jemi për rendin e ditës duke e përfshirë edhe pikën shtesë që e propozoi Kryetari, për vendimin e drejtorive. Përkundër asaj që u thanë nga parafolësit, kjo që po e diskutojmë këtu bashkaërisht tregon më së miri dhe dëshmon se ne nuk duam me shkelë ligjin. Në vazhdim lexoi nenin 56 të Statutit të Komunës së Shtimes, (shih dokumentin). MAPL-ja ka kërkuar që këtyre dy drejtorive të shtuara t’u jepet legjitimitet. Këtu nuk ka ndonjë kundërshtim, por propozohet që kjo të miratohet në Kuvend. Prandaj, ne e përkrahim propozimin që kjo të futet si pikë shtesë. Nuk ka këtu ndonjë shkelje përveç se të merret paraprakisht një miratim formal në Kuvend.

z.Kadri Emini: Përshëndetje! Drejtoreshës së Shëndetësisë, Mimoza Salihut, i uroj suksese dhe punë të mbarë me rastin e zgjedhjes në postin e drejtoreshës. Familjes Hasani i shpërehë ngushllime në emër të grupit parlamentar të LDK-së, për vdekjen e profesorit Ismajl Hasani. Kjo vërtetë nuk është shqetësuese ashtu siç po e paraqet opozita, sepse këto dy drejtor kanë qenë të planifikuara me buxhet, i cili është miratuar në këtë Kuvend. MAPL-ja e bënë monitorimin e vendimeve. Unë e di që ka vendime të tilla që janë marrë më parë nga opozita e sotme. Nëse ndodhë që ky vendim të mos shkojë sot për miratim atëherë do të shkojë në procedurë gjyqësore nga ministria si kontest administrativ. Ne jemi për rendin e ditës me pikën shtesë.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje! Uroj drejtoreshën e shëndetësisë. Jam për pikat e rendit të ditës. Ndërsa për pikën shtesë desha ta pyes Kryetarin se kur ka ardhur ky rekomandim nga Ministria, dhe pse nuk e keni sjellë si pikë të rregullt në Kuvend. Tash po e lypë ligjshmërinë e vendimit e kur u ba propozimi, nuk e keni kërkuar ligjshmërinë sepse thojshi e kemi fuqinë e votës. Fuqia e votës është në kontraditë me vendime.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje! I uroj Mimosës detyrën e re. Pajtoj me pikat e rregullta, por për pikën shtesë të propozuar kam dilema. Unë nuk jam kundër hapjes së drejtorive të reja sepse për drejtorinë e bujqësisë jam që të jetë aty për t’i ndihmuar fermerët. Ne mund tëgabojmë prapë, prandaj, unë propozoj që pika shtesë të shtyhet për mbledhjen e rregullt të ardhëshme, me qëllim që ta konsultojmë edhe Buxhetin e drejtorive. E kemi edhe një drejtor tjetër ilegale që e dini për cilën e kamë fjalën, e që merr pagë. Unë po propozoj që ta analizojmë mirë punën e drejtorive prandaj nuk jamë për me futë në këtë mbledhje.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje! Uroj drejtoreshën për detyrën dhe familjes Hasani ngushllime. Ju po thuani se keni me i ankuar të gjitha vendimet e mëparshme, por po ndodhë që po i ankoni vendimet e juaja të mëparshme. Unë jamë kundër pikës shtesë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ju konfirmoj se kjo pike shtesë, e propozuar nga Kryetari, për drejtorinë, është në koordinim me MAPL-në. Pika shtesë “Propozim-Vendim për formimin e drejtorive komunale” do të jetë si pika e dhjetë e rendit të ditës, ndërkaq pika “Pyetje-Përgjigje” do të jetë pika e njëmbëdhjetë. Në vazhdim Kryesuesi konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

*Kuvendi i Komunës së Shtimes me 11 vota “Për” me 8 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim” miratoi Rendin e Ditës, me pikën shtesë 10. Propozim-Vendim për miratimin e drejtorive komunale.

Pika 1

Ekstrakt-Procesverbali i Kuvendit nga mbledhja e mbajtur më 04.07.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi hapi diskutimin për këtë pikë.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes me 18 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstënim” miratoi Procesverbalin e Kuvendit nga mbledhja e mbajtur më 04.07.2024.

Pika 2

Raporti i auditimit të ZKA-së për pasqyrat financiare të Komunës së Shtimes, për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të fillojmë me shqyrtimin e kësaj pike, unë, në emër të Kuvendit, ju uroj mirëseardhje zotëriut Agron Fetiu - Ndihmës Auditor i Përgjithshëm dhe zotëriut Ramadan Gashi - Drejtor për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza, që sot janë këtu me ne në mbledhjen e Kuvendit për të na e prezantuar raportin e auditimit në formë më të detajuar. Në fillim fjalën ia jap drejtorit për buxhet dhe Financa, z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përsëndetje! Edhe unë i përsëndes zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Mendoj se është praktikë shumë e mirë që sot këtu me neve janë vetë autorët e këtij raporti për komunën tonë. Dëshiroj që kjo praktikë të vazhdojë edhe në të ardhmen. Sa i përket raportit, unë dëshiroj që ta prezantojnë vetë autorët, që janë sot këtu me ne, e pastaj ne mund ta diskutojmë.

z.Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm: Përsëndetje për të gjithë! Më lejoni që para jush sot ta paraqes raportin e auditimit të ZKA-së për komunën e Shtimes gjatë vitit 2023. Ne kemi audituar disa fusha në komunën e juaj dhe si rezultat kemi ardhur në përfundim se i kemi gjithësejt 8 të gjetura të evidentuara, prej tyre 5 janë të gjetura të përsëritura dhe 3 janë të gjetura të reja. Këtu duhet që ta përmendim menjëherë Kontratën Kolektive e nënshkruar në vitin 2015 në mes dy ministrave të atëherëshme dhe Sindikatës pa mbulesë financiare, e cila ka ndikuar dukshëm në vendimet e Gjykatave si detyrime Kontigjente të Komunave. Pastaj kemi edhe disa çështje procedurale të prokurimi, ku është dashur për me i paraqitur te platforma E-prokurimi. Këto të gjetura i kemi edhe te komunat tjera. Ne po shpresojmë që raporti ynë do të shërbejë për të përmirësuar çështjen e menagjimit të aspekteve financiare. Qeverisja lokale për ne është më e vështira sepse ka më shumë sfida për faktin se janë më afër qytetarit dhe prekë direkt në interesat dhe nevojat e qytetarëve. Nëse ka ndonjë pyetje, jemi këtu për tu përgjigjur.

z.Reshat Mujota: Faleminderit për raportin. Auditimi i përgjithshëm është organ i pavarur që na bënë ta kontrollojmë më mirë punën e menagjimit të fondeve publike. Mua më kanë befasuar më shumë 5 të gjeturat e përsëritura dhe ekzekutivi nuk i ka pranuar. Ne, si Kuvendarë, i kemi pa këto lëvizje nëpër kode buxhetore pa dijen e Kuvendit. E kam lexuar edhe Planin e veprimit dhe aty duhet të jetë e shkruar se si do të eliminohen të gjeturat, kah do të merren mjetet financiare dhe si do të zgjidhen këto të gjetura. Çka mundemi ne si Kuvendarë me ndihmu ekzekutivin kur ka bërë shkelje edhe pse ne kemi folë me kohë se nuk është në rregull.

z.Përparim Ramusa: I falënderoj ZKA-në veçanërisht z.Agron Fetion, zëvendës-drejtor i ZKA-së. Ju falënderoj për punën e saktë që e keni paraqitur në tri pika, (shih raportin për 3 pikat). Është fat që jeni ju këtu sepse Kryetari çdo të gjetur e kishte refuzuar, sikurse edhe vendimet nga MAPL-ja.

z.Rrahman Jakupi: Uroj drejtoreshën e DSHMS-së dhe ngushllime për familjen Hasani, për profesorin Ismajl Hasanin, i cili edhe ka qenë kandidat për Kryetar të Komunës së Shtimes. Unë kam një pyetje për auditorët. A keni marrë pjesë edhe në Komunitat e tjera të Kosovës?

z.Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm: Po, ka qenë një praktikë e mirë, që zbatohet edhe në komunat e tjera.

z.Rrahman Jakupi: Unë e vlerësoj shumë prezencën e juaj këtu, që të mos keqkuptohet. Kemi dëshirë të dëgjojmë prej juve se si e kuptoni opinionin e kualifikuar, sepse komuna e Shtimes e ka pranuar opinionin e kualifikuar, na e sqaroni këtë ju lutem. (Në vazhdim lexoi një pjesë nga

raporti i Auditorit të përgjithshëm). Më parë Komuna ka pas opinion të pakualifikuar e tani e ka opinionin e kualifikuar, dmth. sa kemi ramje. Tash e kemi edhe një vendim që na e ka kthyer MAPL-ja për keqmenagjim, e që janë paguar drejtora e zyrtarë në mënyrë të kundërligjshme. Kemi humbë miliona nga ky kualifikim i auditimit. Pyetje për zyrtarët e ZKA-së, a ka elemente të veprës penale në këtë raport të auditimit?

z.Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm; Vërtetë konsideroj se është pak problem me termet në këtë raport. Një gjë është e sigurtë se pasqyrat financiare nuk janë të çrregullta, dhe një ose dy elemente kualifikohen si rekomandime për përmirësim. Ne si ZKA kemi sektorë të veçantë ku të gjeturat analizohen në zyre dhe nëse ka elemente të veprës penale, mund të shkojnë edhe në hetuesi.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje! Faleminderit për raportin dhe faleminderit ZKA-së për punën e tyre. Unë besoj shumë në punën e tyre. Jam në legjislaturën e tretë të Kuvendit dhe për mua është një shqetësim për opinionin e dhënë si i kualifikuar. Duke e parë Kryetarin, për këtë dokument që na ka ardhur këtu, legjislativi nuk mund të pajtohet. Këtu kemi të gjetura që mund të thuhet se ka shkelje. E kemi edhe draftin e buxhetit në pikën tjetër. Ju i keni gjetur 8 keqmenagjime. Unë më shumë i fajësoj ato që janë të përsëritura. Pse nuk kanë marrë masa për me i hjekë? Nuk bënë të punohet veç me fuqinë e votës.

z.Besnik Seferi: Faleminderit ZKA-së për raportin. Në bazë të diskutimit që e morëm nga zotëri Agron Fetiu, tregon se është duke u bërë një punë e madhe dhe nuk është se kemi ndonjë të gjetur të rëndë. Ka të gjetura që kanë qenë edhe në pushtetet e kaluara. Te çështja e të gjeturave duhet të merren masa me planin e veprimt që të hiqen. Kam një pyetje për të gjeturat e përsëritura. A janë të gjetura të mëdha ose a janë të rëndësishme?

z.Kadri Emini: E përgëzoj prezencën e ZKA-së këtu. Sa i përket raportit të auditimit, unë uroj që të vazhdoni më tutje me këtë praktikë. Me një pikë nuk pajtoj me ju që e keni bërë raportin me opinion të kualifikuar, kjo sepse nuk është për fajin e ekzekutivit të komunës tonë, sepse nuk është bërë nga ne, por është nga Ministria. Drejtoria për Buxhet dhe Financa i ka shkruar rregullisht ministrisë, duke i thenë mos na i merrni mjetet financiare këtu në këtë kod por dikund tjetër. Rekomandimet e auditorit kanë karakter udhëzues për ekzekutivin. Ju e keni bërë një punë sepse kështu është dashur të bëhet, por opinion i kualifikuar është pa fajin e Komunës. Unë i propozoj Kryetarit që këtë çështje ta ngrisë në Asociacionin e Komunave.

z.Asllan Beqaj: Përshëndetje edhe për ZKA-në! Në fillim shumë mirë e tha zotëri Fetiu se ka pasur edhe në pushtetet e kaluara. Mendoj se një opinion i kualifikuar është i padrejtë sepse është pa fajin e Kryetarit dhe ekzekutivit të komunës sonë. Nuk është raport si në të kaluarën që nuk janë paguar operatorët ekonomikë për punën e tyre, dmth. Mospagesa e operatorëve, kjo është shkelje ligjore. U tha që humbën miliona për komunën, në të vërtetë ne kemi fituar miliona për qytetarin e komunës tonë. Pyetje. Cila është zgjidhja pa këto të gjetura?

z.Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm: Kontrata Kolektive, siç e thash më parë, ka bërë problem të madh me të gjitha komunat. Ne këtë problem e kemi adresuar edhe në Qeveri, por deri tani kjo nuk është rregulluar. Ne duhet të veprojmë në përputhje me standardet. Ka disa shpenzime që nuk realizohen në përputhje me ligjin ashtu për nga natyra e tyre se si kanë ardhur. Unë shpresoj shumë që në të ardhmen kjo çështje do të zgjidhet dhe rrjedhimisht raportet të jenë më të mira.

znj.Adalina Beqaj: Përshëndetje! Mirë se keni ardhur në komunën tonë ZKA. Në momentin që kemi një raport të kualifikuar, dmth. që raporti nuk është i mirë. Po ju fajësojnë juve për një punë që e keni kryer në mënyrë profesionale. Unë për të ardhmen kërkoj që ta kemi një raport më të mirë të auditimit.

znj.Zejnije Veliu: Përshëndetje për të gjithë, veçanërisht për ZKA-në. Kemi një raport me opinion të kualifikuar, pyetja është se kush është faktori që ka ndikuar që ta kemi një raport të tillë. Këtë duhet analizuar mirë sepse është papërgjegjësi e pushtetit të kaluar e jo e pushtetit të tanishëm. Për nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga pushtetarët e kaluar pa kurrfar mbulese financiare, është pa përgjegjësi totale.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Falënderoj zyrtarët e ZKA-së zotëri Fetiu dhe zotëri Gashin. Unë ndjehem mirë me këtë raportin e auditorit, i cili e pasqyron punën e mirë që e kemi bërë ne si Komunë. Po i citoj fjalët e zotëri Lavdim Maxhunit - Drejtor i Departamentit për Auditim

Financiar dhe Pajtuëshmërisë: “Në këto 18 vite unë nuk kam parë që dikush ka bërë punë më të mirë dhe më të pastër se që e keni bërë ju në Shtime”. Këtë po e them publikisht që ta dëgjojë dhe shohë edhe ai vetë, por edhe qytetarët e komunës sonë. Kjo tregon se sa jemi të përkushtuar për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien. Ne i mirëpresim të gjitha rekomandimet dhe të gjeturat nga ZKA-ja, mirëpo mund të them se këto tri të gjetura nuk lidhen me faktorin tonë por janë faktorë të jashtëm. Në vitin 2013 e dini kush ka qenë në pushtet dhe, ne sot, po duhet të japim llogari për shkelje e çka jo tjetër, kjo nuk po thuhet, por po fliten vetëm fjalë boshe. Duhet të përmendet fakti se raporti nuk ka nxjerrë asnjë abuzim në asnjë fushë, është zero. Kontrata Kolektive ka filluar në vitin 2016 dhe nga pushteti i kaluar nuk ka guxuar askush të kërkojë kompensimet sepse u kanë bërë terror, kështu që pagesat kanë filluar tek në vitin 2022, kur kemi ardhur ne në pushtet. Janë me miliona që ne jemi duke i paguar shkeljet që i kanë bërë qeverisjet e kaluara. Trashëgm, në komunën tonë të Shtimes, i kemi 8 milion euro borgj nga pushteti i kaluar, edhe kjo nëse nuk do t’i kemi të faturuara edhe borgjin nga shpronësimet e pronave të pushtetit të Shtimes. Dhe nëse ndodhë që të na faturohen edhe këto atëherë bëhen 30 milion euro borgje të trashëguara nga pushteti i kaluar në Shtime. Sa i përket atyre 19 mijë eurove dhe atyre 15 mijë eurove, unë do të bëj denoncim në prokurori për keqpërdorim. Për Kontratën Kolektive, më së paku fajtores është komuna e Shtimes, kështu që i bëjmë thirrje të gjitha instancave që të marrin masa me qëllim që të mos marrim shuplaka pa fajin tonë, sepse çdo reduktim na ndëshkon në përmirësimin e punës tonë. E falënderoj ZKA-në, për raportin. Po e përmendi se grantin e performancës e kemi fituar vitin e kaluar falë punës të suksesëshme dhe transparente, mirëpo sivjet nuk mund ta fitojmë për shkak të qeverisjes së kaluar.

z.Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm: Unë mendoj se ne u përgjigjëm drejt në pyetjet e juaja, ne ju falënderojmë, anëtarët e kuvendit dhe ekzekutivin dhe urojmë që vitin tjetër ta kemi raportin shumë më të mirë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Qytetarët vetë mund ta shohin se sa transparent jemi me ta kur prezent janë vetë auditorët për ta prezantuar raportin dhe për t’u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit. I falënderoj edhe një here zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit për prezencën e tyre, prezantimin e raportit dhe përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Pika 3

Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Duke i parë të gjeturat e Auditimit ne kemi ndërmarrë hapa për t’i larguar ato. Kryetari i Komunës ka formuar Grupin e punës, i cili ka punuar në hartimin e planit të veprimit e të cilin ju sot e keni para vetes, për eliminimin e 3 të gjerave të reja dhe 5 të tjera të përsëritura. Për këto të gjetura u fol mjaft shumë në pikën para kësaj për raportin e auditorit të përgjithshëm. Lidhur me pikën e parë ne i kemi shkruar zyrtarisht Thesarit që të mos na i merr mjetet dikund tjetër por te kodi buxhetor paga dhe mëditje, mirëpo ata nuk e kanë marrë fare parasysh këtë kërkesën tonë. Sa i përket pikës tjetër që lidhet me detyrimet Kontigjente, besoj se u sqarua mjaftueshëm se ka të bëjë direkt me nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga pushteti paraprak pa pasur mbulesë financiare, tani ne po pranojmë vendime të Gjykatave të cilat jemi të detyruar me i përmbushë përmes përmbaruesit, ndryshe na i marrin mjetet aty ku munden. Dhe një e gjetur tjetër që lidhet me fushën e bujqësisë, e cila nuk është keqpërdorim, por auditori i rekomandon komunës që ta bëjë më mirë. Kemi një të gjetur që ka të bëjë me operatorin ekonomik “STN” lidhur me hapjen e një barnatore, në vendin ku Komuna ja ka dhënë në shfrytëzim pronën komunale, dhe operatorit i është kërkuar që ta ndërrojë emrin nga “AVAKS” në “STN” si subjekt juridik. Nëse ka ndonjë pyetje për planin e veprimit do të përgjigjem.

znj.Adelina Beqaj: Faleminderit për prezantimin. Mbrojtja më e mirë është sulmi, siç e bëri Kryetari. Ju e keni shkatërruar arsimin. Roli i juaj është me ua ndaluar pagesat që u takojnë arsimtarëve. Kryesues t’i duhet ta ndryshosh qasjen me asambleistat, pse mos me na e mundësuar fjalën. E keni një drejtor të jashtëligjshëm e që ne duhet me e dëgjuar ndonjëherë në Kuvend duke folë.

z.Reshat Mujota: Nuk po di qysh me thënë, a me thënë drejtor apo Ushtrues Detyre. Ju Kryesues i keni prur Auditorët këtu në Kuvend dhe i mësojshi se qysh me folë. Unë e marr ngat zemrës

raportin e Auditorit. Pesë të gjetura të përsëritura, ty po të konvenon me i lanë qashtu qysh janë. (Në vazhdim lexoi një pjesë të dokumentit). Ti si drejtor çka kërkon nga Kuvendi për me të ndihmu në eliminimin e të gjeturave?

z.Përparim Ramusa: Qytetarë të nderuar auditimi është bërë për vitin 2023, e këta po ja lanë fajin pushtetit të kaluar, gjë që nuk është e vërtetë. Kemi një drejtor të paligjshëm. Unë në shenjë revolte e lëshoj mbledhjen e Kuvendit për shkak të paknaqësisë për mosrespektimin e rregullores së punës të Kuvendit, në ora 11:30h. Mbledhjen e Kuvendit e lëshuan edhe anëtarët e tjerë të subjektit politik PDK, si vijon: Përparim Ramusa, Rrahman Jakupi, Adelina Beqaj, Lumni Amrush, Besartë Musliu-Spahija, Hasan Avdyli, dhe Hamëz Tërshani.

z.Rexhep Gashi: Qasjen e juaj si pozitë e keni gabim, grahni punës e jo kështu çka është kah bëhet. Keni bërë të gjetura të reja 3 dhe plus 5 të tjera të përsëritura, leni fjalët e mos u krenoni.

znj.Zejnije Veliu: Faleminderit për prezantimin e Planit të Veprimit. Me vetë faktin që nuk ka pas shkelje, por vetëm disa vërejtje administrative, nuk qëndrojnë diskutimet e opozitës se ka pas shkelje ligjore. Ekzekutivi i komunës edhe përkundër vështirësive që ka pasur me pagesa të pa pritura financiare si rrjedhojë e vendimeve të gjykatave, ja ka dale të kryej pagesat me sukses.

z.Muhamet Ademaj: Faleminderit, Plani i Veprimit është i mirëseardhur dhe mbi bazën e këtij plani duhet të bëhen përpjekje që të largohen të gjeturat e reja që janë 3, por edhe ato 5 të tjerat të përsëritura. Uroj që për vitin 2024 të kemi një raport të mirë të auditorit pa të gjetura.

z.Kadri Emini: Unë i rekomandoj Kryetarit të Komunës që kur ta formojë grupin punues për hartimin e Planit të Veprimit ta bëjë edhe një kordinator për t'i adresuar këto rekomandime në secilin dikaster, sipas Planit të Veprimit, me qëllim që të kemi punë vetëm me një individ, dhe ai të raportojë, për secilën të gjetur se deri ku është arritur zbatimi i saj, dhe ku janë problemet.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: A pajtoheni që të shkojmë në pushim të drekës në ora 12:30 e të kthehemi në mbledhje në ora 13:30?

z.Besnik Seferi: Unë vërtetë po ndihem keq që anëtarët e subjektit të PDK-së e lëshuan mbledhjen, unë u bëj thirrje, që të kthehen në mbledhjen e Kuvendit sepse janë pika të rëndësishme për qytetarët që duhet t'i diskutojmë bashkërisht. E kemi një Plan Veprimi para vetes, që na tregon se si t'i menjanojmë këto të gjetura ashtu si ka rekomanduar Zyra Kombëtare e Auditimit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Auditori e theksoi se raporti është për vitin 2023, në momentin që i kemi marrë këto rekomandime, unë si drejtor, menjëherë i kam ndërrmarrë disa veprime duke e njoftuar Kryetarin dhe Kryetari menjëherë e ka formuar një Komision që ka anëtarë nga të gjitha drejtoritë. Kemi mbajtur disa takime pune dhe si rezultat e kemi nxjerrë Planin e Veprimit se si t'i menjanojmë këto të gjetura. U tha se të gjeturat kryesisht nuk janë me fajin e ekzekutivit të komunës por janë si faktorë të ndikuar nga jashtë. Thesari ti merr mjetet financiare dhe nuk mund ta ndalë askush. Pastaj nënshkrimi i Kontratës Kolektive kur është bërë, është dashur të mbulohet edhe financiarisht.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Me të drejtë kërkohet nga anëtarët e Kuvendit për formimin e Komisionit e që në fakt ne e kemi bërë për çdo vit, mirëpo duhet të kemi vëmendje se disa të gjetura ne nuk mund t'i përmirësojmë sepse nuk janë në kompetencën tonë, psh. po e përmendi statusin e zjarrfiksëve që ka mbetur ende i padeftuar se a do të jenë në kuadër të Komunës apo të Ministrisë, pra ky nuk është faji i jonë sepse ne nuk kemi kompetencë që të vendosim për këtë çështje. Se sa jemi pro mësimdhënësve po shihet përkushtimi ynë për shkollat, për çerdhet, biblioteka, e shumë të tjera. Kontrata Kolektive nuk është problematikë e komunës sonë por e nivelit qendror të nënshkruar nga dy ish ministra të arsimit, pa mbulesë financiare. Planin e Veprimit do të mundohemi ta implementojmë pikë për pikë.

Pika 4

Raporti Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën i jap Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Prezantimi i Raportit periodik buxhetor para Kuvendit është obligim i yni ligjor. Buxheti i Komunës në këtë periudhë raportuese është realizuar 45.43%. Raportin Buxhetor për këtë periudhë e kemi pranuar në formë të shkruar me kohë dhe unë po besoj

që e keni lexuar prandaj unë do të lexoj vetëm shifrat më me rendësi që janë të shpërndara nëpër kode buxhetore, dhe nuk do të ndalem në secilin detaj. Në vazhdim lexoi raportin në pikat kryesore, (shih dokumentin). Nëse ka dikush nga Kuvendarët ndonjë pyetje unë do të përqipem të përgjigjem.

z.Muhamet Ademaj: E falënderoj drejtorin për raportin. Raporti është i prezantuar sipas statistikave të grumbulluara mbi realizimin e buxhetit. Buxheti gjatë kësaj periudhe është realizuar me 45.43% që do të thotë se është në nivelin e kënaqshëm dhe ne si grup parlamentar jemi të kënaqur dhe po shpresojmë se deri në fund të vitit do ta kemi raportin e kompletuar me përqindje të plotë.

z.Rexhep Gashi: Raporti si raport nuk është se është realizuar ashtu siç është planifikuar, sepse psh. te të hyrat kemi 39% më pak se sa që janë planifikuar. Mirëpo, unë mendoj se ka hapësirë të mirë, kërkoj që secili ta kryej punën e vet.

z.Asllan Beqaj: Faleminderit prej drejtorit për një raport shumë të mirë, Buxhetin nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi një tejkalim të realizimit. E mira është se realizimi i buxhetit për vitin 2024 është duke shkuar konform planifikimit dhe priten rezultate shumë të mira në realizimin e buxhetit për vitin 2024.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 11 anëtarëve të Kuvendit prezentë në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimitisht (me 11 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”)** miratoi **Raportin Buxhetor të Komunës së Shtimes për periudhën Janar-Qershor 2024.**

Pika 5

Draft-Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapë diskutimin për këtë pikë ju veç se e dini që ky draft para se të miratohet duhet të shkojë në diskutim publik, edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe atij për Komunitete, i rekomandoj Kuvendit që të marrë vendim për diskutim publik.

z.Muhamet Ademaj: Ne jemi “për” që Draft-Buxheti për vitin 2025 të shkojë në diskutim publik me arsyetimin që t’i dëgjojmë edhe kërkesat e qytetarëve.

z.Besnik Seferi: Edhe ne jemi “për” që të shkojë në diskutim publik, dhe i bëjmë thirrje Drejtorisë për Buxhet dhe Financa që t’i marrë parasysh kërkesat e qytetarëve sipas mundësive financiare.

z.Reshat Mujota: Edhe unë jam, “për” që të shkojë në diskutim publik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 12 anëtarëve prezentë në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimitisht (me 12 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”)** miratoi **vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2025, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, dhe Komitetin për Politikë e Financa.**

Pika 6

Propozim-Vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/189 dt.06.09.2012, për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqes prej 50 ari truall Policisë së Kosovës, Njësia në Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën i jap Grejtalb Eminit.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje! Materialin për këtë pikë e keni pranuar me kohë dhe po besoj e keni lexuar. Ne kemi bërë një propozim-vendim për kthimin e pronës prej 50 ari e cila ju ka dhënë në shfrytëzim Policisë së Kosovës Njësia në Shtime, në vitin 2012, për ta ndërtuar objektin e tyre në këtë parcelë. Meqenëse objekti është i dislokuar në një pjesë tjetër të qytetit, atëherë ne po propozojmë që ky vendim të anulohet me arsyetimin se aty në atë zonë ka plane për ndërtimin e banesave kolektive me kushte të përbalueshme. Kjo parcelë nuk është shfrytëzuar asnjëherë dhe nuk kemi ndonjë problem të asnjë natyre, prandaj ju ftoj që ta votoni.

z.Kadri Emini: Normalisht që ne si grup parlamentar jemi “për” anulimin e këtij vendim, ky vendim nuk është dashur të mbetet deri tani i paanuluar sepse dihet mirë se Policia tani më janë të vendosur në ndërtesën e re të ndërtuar në rrugën “Tahir Sinani” afër Entit Special. I bëj ftesë

DPUKGJ-së që ti kontrollojë edhe vendimet tjera që mund të ketë të tilla dhe ti sjellë në Kuvend për anulim.

z.Reshat Mujota: Edhe unë jamë “Për” anulimin e këtijë vendimi.

z.Asllan Beqaj: Sa i përket anulimit të këtijë vendime normalisht që edhe ne jemi “Për”, por sa i përket ridestinimit të asaj zone për ndërtimin e banesave kolektive me kushte të përballueshme, kjo është një super lajm i mirë për banorët e komunës tonë e sidomos për qiftet e reja.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 12 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht (me 12 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”)** miratoi Vendimin për ANULIMIN e vendimit të Kuvendit Npi-01/189 të datës 06.09.2012, për dhënjen në shfrytëzim, sipërfaqen prej 50 (psëdhjetë) ari sipërfaqe truall për ndërtimin e objektit të Policisë së Kosovës njësia në Shtime, në ngastrën Kdastrale 1398/1; Z.K. – Shtime; Evidentuar (Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal- Shtime).

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pas kësaj pike do të shkojmë në pauzë të drekës në ora 12:13, dhe do të kthehemi në mbledhje në ora 13:40.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Vazhdojmë me pjesën e dytë të mbledhjes së Kuvendit, nga ora 14:00

Pika 7

Propozim-Vendim për formimin e komisionit për emërtimin e Objekteve Publike

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Komiteti për Politikë dhe Financa i rekomandon Kuvendit miratimin e vendimit për formimin e komisionit për emërtimin e Objekteve Publike. Çelësi për formimin e këtijë komisioni është propozuar të jetë prej 7 anëtarëve. Një nga pozita, një nga opozita, dy nga ekzekutivi, dy nga komuniteti intelektual, dhe një nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht vendosi që komisioni të jetë nga 7 anëtarë me çelësin e propozuar.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Tani ju ftoj që t’i propozoni emrat për anëtarë të Komisionit. Konstatoj se në mbledhje nuk janë prezent anëtarët e Kuvendit nga subjekti politik PDK.

z.Besnik Seferi: Kërkoj që kjo pjesë e mbetur e mbledhjes të kalojë mirë. Pak më parë unë pata një konsultim me Reshat Mujotën ku kemi qenë anëtarë të mëparshëm të këtij komisioni. Propozimet unë mendoj se kanë me qenë ato të mëparshmet. Ne nuk jemi “kundër” çfarido propozimi që vjen.

z.Kadri Emini: Unë e përgëzoj ekzekutivin për këtë propozim-vendim për arsye se ky proces duhet të kryhet një herë e përgjithmonë. Sa i përket formimit të komisionit, unë po e vërej një lloj pakënaqësie nga anëtarët e Vetvendosjes, kështu që ne po tërhiqemi nga të dyja grupet, e ju bëni zgjidhje sepse e keni mundësinë. Sipas reagimit po shihet që jo dhe nëse jo atëherë ne e propozojmë Muhamet Ademaj për anëtarë të komisionit.

z.Reshat Mujota: Ne e votuam çelësin dhe unë e përkrahë formimin e këtijë komisioni, por dua të them se ne si anëtarë të mëparshëm të këtij komisioni e kemi bërë një punë të cilën ia vlenë me e marrë parasysh ky komision. Komisionit i uroj që ta bënë një punë të pavarur. Mirë kishte me qenë që me u përcaktu për tipare e kriteret e pastaj edhe me organizu dëgjime publike, me qëllim që Kuvendit me i sjellë rekomandim sa më të mirë. Unë nuk do të jem pjesë e asnjërit komision.

z.Rexhep Gashi: As unë e as Reshati nuk jemi pjesë e KPF-së. Unë nuk do të jem pjesë e asnjërit komision. Nuk është privilegj por është një ngarkesë dhe përgjegjësi. Kemi figura që kanë dhënë kontribute. Kërkoj që komisioni të jetë transparent.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Kërkoj nga LVV-ja që të na japë një propozim për kandidat të komisionit.

z.Asllan Beqaj: Unë e propozoj Besnik Seferin me arsyetimin se ka përvojë në këtë komision.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Zotëri Emini e tha se ka qenë kërkesë e kahmotshme për ta formuar këtë komision për emërtimin e objekteve publike sepse kanë mbetur me dekada pa u emërtuar. Anëtarët e Kuvendit, Reshat Mujota dhe Rexhep Gashi, nuk do të duhej që t’i ikin përgjegjësisë për të marrë pjesë në këto komisione. Qytetarët na kanë dhënë mandat për t’i marrë edhe vendimet e vështira. Kështu që duke e parë nevojën dhe kërkesat e panumërta të qytetarëve për këtë çështje

kemi paraqitur para Kuvendit propozimin për t'i formuar këto komisione. Meqenëse në mbledhje nuk janë anëtarët e opozitës nga PDK-ja në komision do të marrin pjesë përveç anëtarëve nga LVV-ja edhe ata të LDK-AKR-së, në komision do të marrin pjesë edhe Intelktualë të spikatur të komunës së Shtimes si dhe ata të shoqatave të dalura nga lufta e UÇK-së. Meqenëse nga Kuvendi dolën propozimet për Muhamet Ademaj dhe Besnik Seferi, ne kemi propozuar këta emra: Isak Asllani dhe Idajet Rexhepi nga Ekzekutivi, Banush Imeri dhe Basri Hyseni, Intelktual nga komuna jonë dhe Ruzhdi Jashari nga shoqatat e dalura nga lufta e UÇK-së.

z.Reshat Mujota: Për guximin dhe vlerën time e dinë edhe të tjerët. Ne kemi marrë vendime e që ato vendime i keni edhe sot. Unë e kam dëshmuar vetin dhe familja qysh herët. Titujt nuk shpërndahen me urdhëra. E dinë mirë Muhameti dhe Besniku se unë gjithmonë kamë vendosur dhe nuk kam qenë i varur kurrë.

z.Rexhep Gashi: Rreth komisionit nuk ka patriotizëm, por ka përgjegjësi dhe sinqeritet. Ne në Kuvend kemi besim te komisioni që do ta kryej punën mirë, por kjo do të shihet vetëm kur të vie propozimi në Kuvend.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Unë e thash atë që pata për ta thënë. Nuk ka vend këtu fjala guxim. Duhet me pas kurajon për t'i çuar proceset përpara.

z.Kadri Emini: Thash se është mirë që po bëhet emërtimi i objekteve publike. Dy anëtarët prezent të opozitës po tërhiqen, unë po propozoj që ta marrim edhe mendimin e PDK-së, kështu që në mbledhjen e radhës ta rishikojmë edhe një herë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 13 anëtarëve prezentë në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht (me 13 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim") miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për emërtimin e objekteve publike në Komunën e Shtimes, në këtë përbërje: Muhamet Ademaj, Besnik Seferi, Idajet Rexhepi, Isak Asllani, Banush Imeri, Basri Hyseni, dhe Ruzhdi Jashari.**

Pika 8

Propozim-Vendim per formimin e komisionit per emerimin e Rrugeve dhe Shesheve

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Tani po i kërkojmë propozimet e juaja për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes.

z.Asllan Beqaj: Ne si LVV-ë e propozojmë Zejnije Veliun, anëtare të këtijë komisioni.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Kolegët, Reshat Mujota dhe Rexhep Gashi u deklaruan se nuk do të jenë pjesë e asnjërit komision.

z.Muhamet Ademaj: Unë në emër të koalicionit LDK-AKR e propozoj Kadri Eminin anëtar të këti komisioni.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Për sa i përket formimit të komisionit për emërtimin e rrugëve, ne kemi propozuar këta emra: Sami Januzi nga ekzekutivi, Lulzim Sahiti nga ekzekutivi, Abdyl Hajredini nga komuniteti intelektual, Naim Zeqiri nga komuniteti intelektual, dhe Mervete Hasani nga shoqatat e dalura nga lufta e UÇK-së.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 13 anëtarëve prezentë në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht (me 13 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim") miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për vlerësimin e kërkesave lidhur me emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes, në këtë përbërje: Zejnije Veliu, Kadri Emini, Lulzim Sahiti, Sami Januzi, Abdyl Hajredini, Naim Zeqiri dhe Mervete Hasani.**

Pika 9

Informatë nga DKA për përfundimin e vitit mësimor 2023-2024 në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ia jap Yllkë Fejzullahut.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA-së: Përshëndetje! Informatën e keni marrë me kohë në formë të shkruar dhe e keni lexuar (shih dokumentin) mirëpo unë do të lexoj të dhënat kryesore të kësaj informate. Nëse ka ndonjë pyetje jamë këtu për t'u përgjigjur.

z.Asllan Beqaj: Faleminderit për informatën. Siç e dini nëpër shkolla ka pasur mungesa të mëdha në të gjitha fushat arsimore, e sidomos nëpër fshatra. Tani janë renovuar shkollat dhe është

investuar shumë në infrastrukturën shkollore. Janë ndërtuar qerdhet, dmth. kemi arritur në pjesën ku tani kërkesat e drejtuesve të institucioneve janë për rregullimin e shkollëve që janë jasht rrethojave të shkollës por që e përmirësojnë infrastrukturën shkollore për nxënës dhe stafin e shkollës.

z.Besnik Seferi: Faleminderit për informatën e cila ishte mjaft voluminoze. Janë bërë shumë punë të mira dhe a duhet edhe më shumë sigurisht që po. Duhet të përmendet fakti se shkolla fillore në Lagjen e Pajtitit është bërë me nxemje qendrore, që drejtorja e arsimit e meriton një falënderim.

z.Reshat Mujota: Kjo informatë i ka 24 faqe, te faqja e 5 përfundon puna për sa i përket DKA-së, të tjerat janë aktivitete shkollore. Këtu edhe ka ngatërrim të datave në këtë informatë. Gati të njejtën informatë e kemi pas edhe vitin e kaluar. Me cilat aktivitete është marrë DKA-ja? Qka ka kontribuar DKA-ja nëpër revistat shkollore? Pse nuk keni ndërmarrë ndonjë hap për të nderuar ata nxënës që kanë kontribuar. U fol këtu për shkollët te shkolla e mesme, u fol për printera, sa janë funksionale ata? Sa janë pajisur shkollat me material higjienik. Një detaj qershor 2024 te shkolla e Muzeqinës shtatë mijë e diqka më tepër një gjenerator. Kjo informatë nuk mundemi me thanë që është bërë një punë e hajrit. Mesatarja e notës te gjimnazi është 3.10. Pyetje që lidhet me investimet te gjimnazi sa e di nuk ka investime aty, aty nuk ka as printera. Asllanin deshta ta pyes se sa shkolla i ke vizituar dhe a ke raport të punës së vizitave.

z.Asllan Beqaj: Kemi vizituar krejt shkollat. Në Petrovë faktikisht nuk e di se qysh kanë mësuar ata nxënës, kur e shihni se tash është krejtësisht ndryshe në të gjitha aspektet. Në Pjetërshicë po ashtu ka pasur dëmtime dhe janë rregulluar. Në Muzeqinë, Davidovc e Rashincë po rregullohen, madje kolegu ynë Gzim Haxhiu, e mbaj në mend, që ka pas kërkuar edhe banka shkollore, që dmth. aq keq ka qenë gjendja. Tjetra, kemi dhënë 100 bursa për studentë e që ne kemi vërejtë se përpara shumë student as që e kanë ditë fare që komuna ndan bursa për studentë. Me qeverisjen tonë të LVV-së 100% më shumë i është kushtuar rëndësi arsimit në komunën tonë, por është e qartë se krejt problemet nuk mund t'i kryejmë për një ditë.

z.Muhamet Ademaj: E falënderojmë drejtoreshën për informatën. Informata është mjaft e kjo. Janë pasqyruar të gjitha aktivitetet dhe e përgëzoj për punën. Është mirë ta dimë pjesmarrjen e nxënësve në gara komunale dhe republikane. Shqetësimi im është se ka ra shumë numri i nxënësve, siç është rasti me paralelet në Carralevë e Mollopolc, me nga 10 nxënës. Mendoj që do të ndikonte pozitivisht siguri i transportit për këta nxënës.. Faktikisht me punën që po bëhet ne po shohim ditë më të mira për arsimin. Po shpresoj që tani më janë bërë përgatitjet e shkollave sepse jemi në prag të fillimit të vitit të ri shkollor.

z.Rexhep Gashi: Unë mendoj se kjo informatë është pak, ndërsa dikush këtu po mendon se është egzagjeruar. Unë nuk dua të bëj populizëm. Në vitin 2000 i kemi pas shkollat më të shkatërruara dhe është punuar më shumë. Shqetësuese për mua është se sot te shkolla profesionale kemi vetëm 421 nxënës. Dhe kur e shohim suksesin e testit në elektroteknikë asnjë nuk ka kaluar. Në Ekonomi 22 nxënës kanë hy e vetëm 5 kanë kaluar. Këtij nuk mund ti themi sukses.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoresh e DKA: Besniku tha dhe pajtohem se gjithmonë ka vendë për më shumë dhe më mirë. Zotëri Reshatin nuk mund ta cilësoj si një ekspert të arsimit. U kap te faqja e pestë e informatës dhe mendoj se kjo do të thotë që ne punët i kemi mirë, e tani po kapet vetëm te këto punët e vogla fare. Po kërkohen fonde më shumë në fushën e arsimit, do të ishte mirë sigurisht, por qeverisja ka edhe segment tjerë. Është interesant qysh mos të përmenden fare bursat e studentëve, pastaj investimet e mëdha që janë bërë në renovimin e shkollave, e kuptojmë që mund të ketë pasur problem teknik, por ne jemi aty për t'i zgjidhur. Në Gjimnaz kemi investuar 200.000 euro. U përmend gjeneratori, edhe ky është investim i nevojshëm që ka kushtuar rreth 7000 euro. Te testi i maturës kemi pas një rritje. Për zgjedhjen e drejtorëve është një proces që është duke ndodhur. Me gjithë opozitarizmin tënd, nuk bënë mos me e përmendë investimin në paisje dhe inventarë. Orë të humbura gjithsej janë 632 e jo shifra të tjera që po jepen.

z.Reshat Mujota: Lidhur me pyetjet që t'i bëra unë, ti ke bërë një qasje krejt të kundërt, unë nuk qesha për gjeneratorin, por për informatën. Këtu ke ardhur me punu e jo me ndejtë. Bëra pyetje çka ka kontribuar DKA-ja për revistën shkollore të Gjimnazit e mos e shtrembëro diskutimin dhe thash pse nuk i falënderoni ata nxënës për punën dhe aktivitetin e tyre. Sa për dijeni prindërit kanë participuar për t'i siguruar uniformat e nxënësve. Nuk u përgjigje për printera edhe për pajisje higjienike.

z.Besnik Seferi: Kolegu tha se Gjumnazi është rinovuar, por shkallët nuk janë pjesë e saj, edhe shkallët janë ndërtuar para se gjithash për nxënës. Pajtohem me drejtoreshën se janë bërë shumë punë të mira. Një informatë e tillë e DKA-së neve na jep një pasqyrë të qartë për gjendjen në arsim, në komunën tonë, dhe po ashtu na ndihmon të pajsemi me informata edhe më të detajuara. Duhet kuptuar edhe faktin se ka edhe pak nevojë për promovim para qytetarëve, mirëpo prap po them se a ka nevojë për më mirë, sigurisht që ka nevojë.

z.Reshat Mujota: Sa për kamera e promovim unë nuk e kam fare atë problem, sepse dihet që t'i ma kalon mua shumëfish. Qemajl Aliut, i kam ndihmuar në gjithqka, i kemi ndihmuar për me fitu, por ky ose ka një krenari të tepruar ose ka një urrejtje ndaj meje. Unë i bëra pyetje konkrete drejtoreshës, nëse përgjigjen do ta kisha konkrete normalisht që edhe unë do të jem i shkurtër. Sot ka rrezik që për shkak të transportit, në Mollopolc, mund të shuhet një klasë, sepse 4 kilometra vijnë nxënësit në shkollë në Shtime.

Kryetari, Qemajl Aliu: Sa po muj me vërejtë prej momentit që Rexhep Gashi nuk është më duke punuar profesor, arsimiti po lulëzon. E Reshat Mujota, prej se është bërë kryetarë i Këshillit të Prindërve, po mbanë leksione për arsim, një gjë është e vërtetë se duhet ta dimë secili punën e vet.

z.Reshat Mujota: Unë në Këshillin e Prindërve jam zgjedhur me votë, kjo është e para dhe e dyta ajo është punë vullnetare, pa pagesë.

z.Rexhep Gashi; Kryetar, nuk po i kontribuon mbledhjes së Kuvendit. Unë jam krenar për punën time, pavarësisht se ku kam punuar. E për Besnikun të gjithë e dimë se ka merak me dalë në TV e Facebook.

Pika 13 (Pikë shtesë)

Propozim-Vendim për miratimin e drejtorive komunale

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini: Unë mendoj se është e qartë kjo pikë, sepse e kemi obligim ligjor të konfirmuar edhe nga MAPL-ja, e cila ka kërkuar edhe nga Kuvendi miratimin e drejtorive komunale. Ne si grup parlamentar jemi “Për”.

z.Reshat Mujota: Realisht këtu është fjala për drejtorinë për buxhet dhe financa dhe për drejtorinë e bujqësisë. E kemi një kthim nga MAPL-ja për rishqyrtimin e vendimit për drejtoritë. A ka mundësi të na sillni atë vendim të ministrisë që ta shohim dhe ta analizojmë edhe ne dhe pastaj ta votojmë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Lexoi nenin 54.4 i cili thot: “ Kryetari i propozon Kuvendit të Komunës, për çdo vit fiskal, numrin e drejtorateve dhe funksionet e tyre, në pajtim me legjislacionin në fuqi” si dhe nenin 56.2 të Statutit të Komunës, i cili thot: “Kuvendi i Komunës, për çdo vit fiskal, në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës, me Vendim të posaçëm, vendos për numrin e drejtorive”. Siç e dini, ne në Kuvend e kemi miratuar buxhetin për vitin 2024 duke përfshirë edhe financimin e klëtyre drejtorive, tani na mbetet vetëm që t'i votojmë edhe formalisht.

z.Rexhep Gashi: Jemi te pika shtesë ku po diskutohet për një vendim të kundërligjshëm. Kështu e keni prezantuar në fillim, ndërkaq që ne kemi thënë qysh po e formoni drejtorinë e Inovacionit, e ju i keni bërë edhe dy drejtori të tjera. Ne nuk jemi kundër drejtorive, por kundër mënyrës se si po administrohet. Unë jam kundër për formimin e këtyre dy drejtorive.

z.Kadri Emini: Po flitet këtu për drejtori të ligjshme e të paligjshme. Unë mendoj se formimi i drejtorive është i pasqyruar në buxhet e që unë mendoj se është e drjetë. Nëse tash MAPL-ja thot se nevojitet një vendim i Kuvendit për drejtoritë komunale ne po e marrim këtë vendim dhe kryhet puna.

z.Besnik Seferi: Dy kolegët thoshin përpara se është në rregull. Ne jemi “Pro” këtij vendimi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 11 anëtarëve prezentë në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimitisht (me 11 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”) miratoi numrin dhe emërtimin e Drejtorive të Administratës të Komunës së Shtimes si vijon: Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, (DAP); Drejtoria për Buxhet dhe Financa, (DBF); Drejtoria Komunale për Arsim, (DKA); Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, (DSHMS); Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, (DZHE);

Drejtoria për Shërbimeve Publike, (DSHP); Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, (DKRS); Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, (DBZHR); Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, (DPUKGJ); Drejtoria për Inovacion dhe Zhvillim të Projekteve, (DIZHP); Drejtoria për Prokurim Publik. (DPP).

Pika 11

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj; Unë kam një pyetje për drejtorinë e Bujqësisë, jam i njoftuar nga disa bujqë se në komunën tonë sidomos në zonat më malore ka dëmtime të kulturave bujqësore nga Thitë e egër, mendoj se është mirë për me formuar një komision dhe me dalë në teren e me e bërë një vlerësim të dëmeve?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse nuk kemi diskutime të tjera, atëherë mbledhjen e përfundoi në ora: 16:04h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

